



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 26.10.2016

PËR

**PËR PROPOZIMIN PËR MIRATIM, NË KËSHILLIN E MINISTRAVE,
TË PROJEKTVENDIMIT “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE
TË SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 93, të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozim të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Propozimin për miratim, në Këshillin e Ministrave, të projektvendimit “Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative”, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi”.
2. Tarifat për shpenzimet administrative përfshijnë:
 - a) tarifatat e aplikimit për pajisjen me leje/autorizim, për përdorim burimi ujor, pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe në Agjencinë e Basenit Ujor;
 - b) tarifatat e miratimit të lejes/autorizimit, për përdorim burimi ujor, nga Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Këshilli i Basenit Ujor.
3. Të ardhurat e mbledhura nga tarifatat e përcaktuara në këtë vendim derdhen në buxhetin e shtetit.
4. Ngarkohet ministri propozues të ndjekë procedurën ligjore për shqyrtimin dhe miratimin e këtij akti në Këshillin e Ministrave.
5. Ngarkohen ministria përgjegjëse për ujërat, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Ministria e Financave dhe Agjencitë e Baseneve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I
E D I R A M A**

Në mungesë
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
N I K O P E L E S H I**

**M I N I S T R I
E D M O N D P A N A R I T I**



Tabela nr.1

Formulari	Emërtimi	Tarifa e aplikimit për leje/autorizim për përdorim burimi ujor (në lekë)		Institucioni ku aplikohet		Tarifa e leje/autorizimeve për përdorim burimi ujor (në lekë)		Institucioni miratues	
		Familjarë	Biznes	STKKU	ABU	Familjarë	Biznes	KKU	KBU
A/1	“Kërkesë për ujë të pijshëm”	1 500	3 000		X	5 500	50 000		X
A/2	“Kërkesë për ujë për ambalazhim në shishë, enë ose autobot/cisternë për pijë alkoolike dhe joalkoolike.	-----	5 000	-----	X	-----	100 000	-----	X
A/3	“Kërkesë për ujë për qëllime sanitare”	-----	3 000	-----	X	-----	50 000	-----	X
A/4	“Kërkesë për ujë, për ujtiqe në bujqësi”	1 500	3 000	-----	X	5 000	30 000	-----	X
A/5	“Kërkesë për ujë për akuakulturë”	1 500	3 000	-----	X	5 000	50 000	-----	X
A/6	“Kërkesë për ujë për prodhim hidroenergji”	-----	5 000	X >2MW	X < 2MW	-----	100 000	X	X
A/7	“Kërkesë për ujë për përdorim teknologjik”, përjashto industrinë e kripës.	1 500	3 000	-----	X	5 000	25 000	-----	X
A/8	“Kërkesë për ujë për qëllime turistike”	1 500	3 000	X Veprimtari në det	X	5 000	50 000	X	X
A/9	“Kërkesë për shfrytëzim materialësh inerte” deri në 10 000 m ³ 10 000 m ³ – 100 000m ³ 100 000 m ³ – 1 000 000m ³	1 500 ----- -----	3 000 5 000 10 000	-----	X X	5 000 ----- -----	100 000 150 000 200 000	-----	X X
B/1	“Kërkesë për leje për hapjen e një pus-shpimi”	-----	3 000	-----	X	-----	10 000	-----	X

B/2	“Kërkesë për leje për përdorim të një pus-shpimi” : nga 0.1 – 5 l/sek Nga 5 – 10 l/sek, >10 l/sek	1 500	3 000	-----	X	5 000	10 000 20 000 100 000	-----	X
B/3	“Kërkesë për leje për përdorim të një pusi ekzistues”	1 500	3 000	-----	X	5 000	50 000	-----	X
B/4	“Kërkesë për rinovim leje për përdorim të një pus-shpimi”	1 500	3 000	-----	X	5 000	50 000	-----	X
C	Tarifa për përdorim të ujërave kurative, termominerale, minerale dhe gjeotermale	-----	5 000	-----	X	-----	100 000	-----	X
D a	Kërkesë për autorizim, për përdorim të burimit ujor, për kërkime në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	-----	-----	-----	X	-----	-----	-----	X
b	Kërkesë për autorizim, për përdorim të burimit ujor, për studime në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	-----	-----	-----	X	-----	-----	-----	X
c	Kërkesë për autorizim, për përdorim të burimit ujor, për eksplorime në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	-----	-----	-----	X	-----	-----	-----	X
----	Kërkesë për autorizim, për përdorim të burimit ujor, për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh.	1 500	3 000	-----	X	5 000	25 000	-----	X
----	Kërkesë për autorizim, për shfrytëzim të ujërave nëntokësore për qëllime shtëpiake	1 500	-----	-----	X	5 000	-----	-----	X
----	Kërkesë për autorizim për përdorimin ose ripërdorimin e	1 500	-----	-----	X	5 000	-----	-----	X

